

VENDIM
Nr.611, datë 11.6.2009

**PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË PARCELAVE NDËRTIMORE, NË
FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç” të nenit 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të nenit 175 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit në pronësi të poseduesve të objekteve informale, të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore, të zëna, sipas listës dhe planvendosjeve përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi, në:

- qarkun e Tiranës, 2918 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 881 249,29 (tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e dyzet e nëntë presje njëzet e nëntë) m² ;
- qarkun e Beratit, 162 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 46 536,25 (dyzet e gjashtë mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë presje njëzet e pesë) m² ;
- qarkun e Elbasanit, 459 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 110 314,18 (njëqind e dhjetë mijë e treqind e katërbëdhjetë presje tetëmbëdhjetë) m² ;
- qarkun e Fierit, 250 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 67 027,15 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëzet e shtatë presje pesëmbëdhjetë) m² ;
- qarkun e Durrësit, 713 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 252 313,93 (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e trembëdhjetë presje nëntëdhjetë e tre) m² ;
- qarkun e Lezhës, 345 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 73 299,85 (shtatëdhjetë e tre mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë presje tetëdhjetë e pesë) m² ;
- qarkun e Dibrës, 30 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 9800 (nëntë mijë e tetëqind) m² ;
- qarkun e Gjirokastrës, 58 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 6 798,20 (gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë presje njëzet) m² ;
- qarkun e Korçës, 12 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 3 234,26 (tre mijë e dyqind e tridhjetë e katër presje njëzet e gjashtë) m² ;
- qarkun e Kukësit, 166 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 76 535,87 (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tridhjetë e pesë presje tetëdhjetë e shtatë) m² ;
- qarkun e Vlorës, 1 408 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 561 353,56 (pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e pesëdhjetë e tre presje pesëdhjetë e gjashtë) m².

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore, të objekteve informale, nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha